



SHSKUK

Shërbimi Spitalor dhe Klinik
Universitar i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës-(SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)
Hospitaland University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)

Raport Financiar Janar-Dhjetor 2024

Prishtinë
Shkurt, 2025



Përmbajtja:


Tabela e shkurtesave.....	3
1. Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve.....	4
2. Shpenzimet buxhetore në kategorinë e Pagave dhe medijtjeve.....	6
3. Buxheti i shpenzuar për Mallra dhe Shërbime.....	7
4. Buxheti i shpenzuar për Investime Kapitale.....	8
5. Buxheti i shpenzuar në kategorinë Komunale.....	9
6. Të hyrat vetanake.....	10
7. Bilanci Gjendjes në SHSKUK.....	11
8. Asetet (pasuritë).....	11
9. Detyrimet dhe Kapitali.....	12
10. Krahasimi i shpenzueshmërisë financiare në SHSKUK (2020-2024).....	13

Tabela e Shkurtesave

Shkurtesa	Përshkrimi
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
BD	Bordi Drejtues
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKUSK	Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës
QKMP	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Punës
QKMS	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
QKTK	Qendra Kombëtare e Telemjekësisë së Kosovës
SP	Spitali i Përgjithshëm
QSHMSHIB	Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi
QIRSKP	Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik
BQ	Barnatorja Qëndrore
Pasqyrat Fianciare	Pasqyrat financiare janë dokumente kontabël që paraqesin gjendjen financiare, performancën dhe ndryshimet në pozicionin financiar të një entiteti gjatë një periudhe të caktuar. Pasqyrat financiare ofrojnë një pamje të qartë dhe të strukturuar të shëndetit financiar të një institucioni.
Bilanci i Gjendjes (Balance Sheet)	Paraqet asetet, detyrimet dhe kapitalin e institucionit në një moment të caktuar.
Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve (Income Statement)	Tregon të hyrat, shpenzimet dhe rezultatin financiar (fitim/humbje) gjatë një periudhe.
Llogaritë e arkëtueshme	Janë shuma parash që një entitet (institucion, biznes apo organizatë) ka për të marrë nga palët e treta (klientë, partnerë, institucione publike ose private) për mallrat apo shërbimet e ofruara, por ende të papaguara.
Suficiti Buxhetor	Kur të ardhurat e një qeverie apo institucioni publik janë më të larta se shpenzimet, duke krijuar tepriçë financiare.

1. Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore të SHSKUK


Të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin fiskal 2024:



Të hyrat dhe shpenzimet e Buxhetit sipas Kategorive Ekonomike

- ❖ **Paga dhe meditje** – 89,972,000 € realizim nga 89,975,000 €, pra 100% përdorim efektiv.
- ❖ **Mallra dhe shërbime** – 63,711,000 € nga 66,255,000 €, duke rezultuar në 96% realizim me 2.54 milionë € të papërdorura.
- ❖ **Shpenzime komunale** – 3,626,000 € nga 3,639,000 €, duke arritur 100% shfrytëzim.
- ❖ **Kapitalet** – 13,040,000 € nga 13,838,000 €, me 94% realizim dhe 798,000 € mbetje.
- ❖ **Gjithsej** – 170,349,000 € nga 173,707,000 €, që do të thotë 98% e buxhetit është shfrytëzuar.

Grafiku tregon se buxheti është ndarë kryesisht në katër kategori:



- **Paga dhe mëditje (52%):** Pjesa më e madhe e buxhetit shkon për të paguar punonjësit dhe për të mbuluar shpenzimet e tjera të lidhura me burimet njerëzore.
- **Mallra dhe shërbime (38%):** Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit përdoret për të blerë mallra dhe shërbime të ndryshme që janë të nevojshme për funksionimin e organizatës.
- **Kapitale (8%):** Një pjesë më e vogël e buxhetit është e dedikuar për investime të tilla si blerja e aseteve të reja dhe ndertimet.
- **Komunale (2%):** Pjesa më e vogël e buxhetit shkon për shpenzimet komunale, siç janë faturat e ujit dhe të energjisë elektrike.

2. Shpenzimet buxhetore në kategorinë e Pagave dhe medijtjeve:

KATEGORIA	VLERA FINANCIARE (€)	PËRQINDJA (%)
PAGA NETO	55.346.194,65	62
TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	5.914.178,19	7
KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI	4.248.620,34	5
SINDIKATAT	76.971,56	0
ODAT PROFESIONALE	299.533,84	0
PËRVOJA E PUNËS	3.733.909,86	4
KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	4.248.620,34	5
SHTESA PËR KUSHTET E TREGUT TË PUNËS	413.636,60	0
SHTESA PËR VËLLIMIN E PUNËS	1.553,23	0
SHTESA PËR NËPUNËSIN E SISTEMIT SHËNDETËSOR	589.685,78	1
KUJDESTARIA, PUNA NATËN & JASHTË ORARIT	14.383.930,10	16
FUNKSIONET SHITESË	172,49	0
SHTESAT TRANZITORE	117.383,52	0
VENDIMET GJYQËSORE	600.787,92	1

Shpenzimet kryesore:

- Paga Neto (62%) – 55.346.194,65 €
- Kujdestaria, puna natën & jashtë orarit (16%) – 14.383.930,10 €
- Tatimi në të ardhurat personale (7%) – 5.914.178,19 €
- Kontributet pensionale (10%) – 8.497.240,68 €
- Përvoja e Punës (4%) – 3.733.909,86 €
- Vendimet Gjyqësore (1%) – 600.787,92 €

Shpenzime minimale: Sindikatat, Odat Profesionale, Funkcionet Shtesë, Shtesat Tranzitore.

Buxheti i kategorisë së pagave shpenzohet kryesisht në pagat bazë dhe shpërblimet për punën jashtë orarit, ndërsa shpenzimet për tatime, kontribute pensionale dhe kategori të tjera mbeten më të ulëta.

3. Buxheti i shpenzuar për Mallra dhe Shërbime

Kategoria e shpenzimeve	Vlera Financiare (€)	Përqindja (%)
Transporti për udhëtime zyrtare	43.241,26	0.07%
Shërbimet e komunikimit (Internet, Telefoni)	87.952,45	0.14%
Shërbimet e trajnimeve dhe arsimit	11.056,00	0.02%
Shërbimet ligjore dhe këshillimore	1.565,00	0.00%
Shërbimet kontraktuese	3.022.586,60	4.74%
Sigurimi fizik i objekteve publike	414.796,26	0.65%
Furnizimi me pajisje teknologjike	1.156.596,99	1.81%
Furnizimet për zyrë	543.237,66	0.85%
Furnizimet mjekësore	44.232.741,09	69.41%
Furnizimet për pastrim	481.023,82	0.75%
Furnizimi me ushqim dhe pije	3.048.371,52	4.78%
Karburant dhe energji (Mazut, Naftë, Dru)	1.232.395,97	1.93%
Mirëmbajtja e automjeteve dhe ndërtesave	7.605.363,19	11.93%
Vendimet gjyqësore dhe tarifaf	1.146.090,94	1.80%
Shërbime të tjera	3.911.927,64	6.14%
Totali	63.711.038,94	100%

Totali i shpenzimeve për mallra dhe shërbime arrin në 63.711.038,94 €, ku shpenzimi më i madh është për furnizimet mjekësore (69.41%), të cilat përfshijnë barna dhe material shpenzues mjekësor të nevojshëm për funksionimin e institucioneve shëndetësore dhe trajtimin e pacientëve. Kjo kategori përfaqëson një prioritet të lartë në buxhet, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve shëndetësore.

Një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve i dedikohet mirëmbajtjes së ndërtesave dhe automjeteve (11.93%), duke përfshirë riparimin dhe funksionimin e infrastrukturës së domosdoshme për institucionin. Shërbimet kontraktuese (4.74%) dhe furnizimi me ushqim dhe pije (4.78%) janë gjithashtu shpenzime të rëndësishme për menaxhimin e përditshëm dhe mbështetjen e personelit dhe pacientet e njësisë përbërëse të SHSKUK.

Ndër shpenzimet tjera përmenden karburanti dhe energjia (1.93%), të cilat mbështesin transportin dhe ngrohjen, si dhe vendimet gjyqësore dhe tarifaf (1.80%), që përfaqësojnë pagesat për detyrimet ligjore.

4. Buxheti i shpenzuar për Investime Kapitale

Kategoria	Vlera Financiare (€)	Përqindja (%)
Ndërtesat shëndetësore	3.973.514,64	30.21%
Rrjetet e kanalizimit	13.389,00	0.10%
Pajisjet mjekësore	8.517.508,20	64.76%
Pajisjet e tjera	631.838,16	4.80%
Pagesat sipas vendimeve gjyqësore	15.628,53	0.12%
Totali	13.040.000,00	100%

Totali i investimeve kapitale për këtë periudhë arrin në 13.040.000,00 €, me pjesën më të madhe të shpenzimeve të përqendruara në pajisje mjekësore (64.76%). Ky investim mundëson modernizimin dhe fuqizimin e kapaciteteve teknologjike të institucioneve shëndetësore,

Ndërtesat shëndetësore përbëjnë 30.21% të buxhetit, të cilat janë orientuar për ndërtimin, rinovimin dhe përmirësimin e infrastrukturës spitalore.

Shpenzime më të vogla, si pajisjet e tjera (4.80%), rrjetet e kanalizimit (0.10%) dhe pagesat sipas vendimeve gjyqësore (0.12%), përfaqësojnë një pjesë më të vogël të buxhetit, por mbeten të rëndësishme për funksionimin dhe përmbushjen e detyrimeve institucionale.

5. Buxheti i shpenzuar në kategorinë Komunale

KATEGORIA E SHPENZIMEVE	VLERA FINANCIARE (€)	PËRQINDJA (%)
ENERGJIA ELEKTRIKE	1.601.087,26	44.16%
SHËRBIMET E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT	750.235,96	20.69%
MBETURINAT	517.818,93	14.28%
NGROHJA QENDRORE	593.477,79	16.37%
TELEFONIA FIKSE	34.785,99	0.96%
PAGESAT - VENDIME GJYQËSORE	128.640,76	3.54%
TOTALI	3.626.046,69	100%

Totali i shpenzimeve komunale për këtë periudhë arrin në **3.626.046,69 €**, me **energjinë elektrike (44.16%)** që përbën shpenzimin më të madh. Kjo tregon një varësi të lartë nga energjia për funksionimin e institucioneve.

Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit (20.69%) janë shpenzimi i dytë më i madh, duke reflektuar rëndësinë e infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe sistemit të kanalizimit. Po ashtu, **ngrohja qendrore (16.37%)** mbetet një kosto e rëndësishme, sidomos për ambientet institucionale që kërkojnë temperatura optimale gjatë gjithë vitit.

Menaxhimi i **mbeturinave (14.28%)** përbën një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve, duke theksuar nevojën për mirëmbajtjen e kushteve higjienike dhe pastrimin e hapësirave institucionale. **Shpenzime më të vogla, si telefonia fikse (0.96%) dhe pagesat për vendime gjyqësore (3.54%)¹**, ndonëse të ulëta në vlerë, janë të rëndësishme për funksionimin administrativ dhe përbushjen e detyrimeve ligjore.

¹ Pagesat për vendime gjyqësore janë realizuar nga të gjitha kategoritë ekonomike, pasi që ekzekutuimi i tyre bëhet me vendim gjyqësor/përmbarimor. Gjithsej pagesat për vendimet gjyqësore gjatë vitit 2024 ishte 1,891,148.15 euro.

6. Të hyrat vetanake

KATEGORI	VLERA FINANCIARE (€)	PËRQINDJA (%)
PARKING	342.325,50	9.78%
CERTIFIKATA MJEKËSORE	486.352,00	13.89%
SHITJA E SHËRBIMEVE	75.547,42	2.16%
SHITJA E MBETURINAVE	5.719,50	0.16%
QIRAJA	142.383,03	4.07%
PARTICIPIMI	2.449.131,13	69.97%
DONACIONET	0,00	0.00%
TOTALI	3.501.458,58	100%

Totali i të ardhurave është **3.501.458,58 €**, ku burimi kryesor është **participimi i qytetarëve (69.97%)**, duke treguar varësinë e lartë nga pagesat e drejtpërdrejta. **Certifikatat mjekësore (13.89%)** dhe **parkingu (9.78%)** janë burime të rëndësishme, ndërsa **shitja e shërbimeve (2.16%)** dhe **qiraja (4.07%)** mbulojnë një pjesë më të vogël të të ardhurave.

7. Bilanci Gjendjes në SHSKUK

Bilanci i Gjendjes				
Pasuria (asetet)			Detyrimet dhe kapitali	
Emertimi		Vlera ne euro	Emertimi	Vlera ne euro
Pasuria mbi 1,000.00 euro	Ndertesat banesore	70,950,361.17	Detyrimet kontigjente	5,986,000.00
	Struktura tjera	4,390,671.03	Detyrimet per mallra	1,122,707.80
	Mobile	4,213,133.71	Detyrimet per komunale	362,735.17
	Pajisje speciale mjeksore	29,197,644.54	Detyrimet kapitale	223,300.23
	Automjete transporti	1,578,634.19		
	Toka	118,441,630.84		
	Investimet ne vijim	22,098,138.70		
	Infrastruktura	603,515.69		
P. nen 1,000.00	Pajisje dhe mobilje	5,058,303.87		
Gjithsej asetet fikse		256,532,033.74	Gjithsej detyrimet	7,694,743.20
Asetet afatshkurera	Stoqet	12,854,659.61		
	Llogarite e arketueshme	3,467.00	Kapitali	261,695,417.15
Asetet qarkulluese		12,858,126.61		
Gjithsej pasuria		269,390,160.35	Gjithsej detyrimet dhe kapitali	269,390,160.35

8. Asetet (Pasuritë)

Institucioni ka një pasuri totale prej 269.390.160,35 €, e cila ndahet si më poshtë:

Asetet fikse (256.532.033,74 € – 95,22%)

- **Toka (118,44 milion € – 45,97%)** dhe **ndërtesat banesore (70,95 milion € – 27,38%)** janë asetet kryesore, duke reflektuar natyrën publike të institucionit.
- **Pajisjet speciale mjekësore (29,19 milion € – 11,38%)** dhe **investimet në vijim (22,09 milion € – 8,62%)** tregojnë prioritetin për sektorin shëndetësor dhe zhvillimin teknologjik.

Asetet qarkulluese (12.858.126,61 € – 4,78%)

- **Stoqet (12,85 milion € – 99,97%)** tregojnë rezervat e furnizimeve dhe pajisjeve mjekësore.
- **Llogaritë e arkëtueshme (3.467 € – 0,03%)** janë minimale, pasi institucioni nuk operon me financa private.

9. Detyrimet dhe Kapitali

Detyrimet totale (7.694.743,20 € – 2,86%)


- **Detyrimet kontingjente (5,98 milion € – 77,78%)** reflektojnë pagesa të mundshme për vendime gjyqësore ose kontrata të hapura.
- **Detyrimet për mallra dhe komunale (1,48 milion € – 19,29%)** janë shpenzime të zakonshme operative.

Kapitali (261.695.417,15 € – 97,14%)

- Institucioni mbështetet në kapitalin e tij dhe **nuk ka varësi nga borxhet.**
- Struktura financiare është e fortë, me pasuri të mbështetura nga fondet publike.

10. Krahasimi i shpenzueshmërise financiare në SHSKUK (2020-2024)²

Viti	Buxheti Total (€)	Shpenzuar (€)	Mbetja (€)
2024	173.707.000,00	170.349.000,00	3.358.000,00
2023	156.978.030,00	154.716.693,00	2.261.337,00
2022	133.611.273,00	129.074.526,00	4.536.747,00
2021	137.447.117,00	135.272.573,00	2.174.544,00
2020	132.065.364,00	126.022.000,00	6.043.364,00



Nga te dhenat e paraqitura në tabelë shihet një rritje progresive e buxhetit – Nga 132 milion € (2020) në 173,7 milion € (2024), duke reflektuar rritjen e investimeve dhe nevojave financiare.

Efikasitet i lartë i shpenzimeve – Në 2024 u shpenzua 98,07% e buxhetit, duke treguar një përdorim efektiv të fondeve.

Mbetja e fondeve – Mbetja e fondeve ka variuar nga 2,17 milion € në 6,04 milion €, me vitin 2020 që shfaqte mbetjen më të lartë.

Përdorimi më i mirë i fondeve – Nga 95,42% në 2020 në 98,07% në 2024, **duke treguar përmirësim të menaxhimit financiar.**


Stabilitet në menaxhimin e shpenzimeve – **Institucioni ka ruajtur një mesatare mbi 96% të shpenzimeve efektive çdo vit.**

²² Të dhënat e krahasuara janë përdorur nga raporti financiar 2024 dhe raporti aktiviteteve financiare të SHSKUK në vitin 2023, të përgaditur nga ZKF i SHSKUK.



11. Analiza e Shpenzimeve në SHSKUK nga viti 2021-2024

Kategoria	Shpenzuar 2021 (€)	Shpenzuar 2022 (€)	Shpenzuar 2023 (€)	Shpenzuar 2024 (€)
Paga dhe Mëditje	73.820.177,00 €	70.231.105,00 €	84.532.481,00 €	89.972.000,00 €
Mallra dhe Shërbime	48.653.315,00 €	49.576.205,00 €	58.769.656,00 €	63.711.000,00 €
Shpenzime Komunale	3.586.553,00 €	3.542.744,00 €	4.175.220,00 €	3.626.000,00 €
Investime Kapitale	9.207.283,00 €	5.716.550,00 €	7.239.337,00 €	13.040.000,00 €
Gjithsej	135.267.328,00 €	129.074.526,00 €	154.716.693,00 €	170.349.000,00 €



- **Rritje e pagave dhe mëditjeve:** Nga **73,8 milion € (2021)** në **89,97 milion € (2024)**, me një rritje të konsiderueshme prej **22%** në katër vite.
- **Shpenzimet për mallra dhe shërbime** janë rritur në mënyrë të konsiderueshme nga **48,6 milion € në 2021** në **63,7 milion € në 2024 (+31%)**, duke rritur shpenzueshmerine për furnizime dhe mirëmbajtje më të madhe.
- **Shpenzimet komunale janë të qëndrueshme**, me një mesatare prej **3,6-4,1 milion €** çdo vit.
- **Investimet kapitale kanë pësuar luhajtje**, me një ulje të ndjeshme në 2022 (5,7 milion €), por një rritje e konsiderueshme në **2024 (13,04 milion €)**, duke treguar orientim investiv më të madh në infrastrukturë dhe pajisje të reja.
- **Shpenzimet totale janë rritur nga 135,26 milion € në 170,34 milion € (+26%)** në katër vite, duke reflektuar zgjerimin e shërbimeve dhe rritjen e kostove operacionale.
- **Rritja më e madhe është në vitin 2024**, me një shpenzim prej **170,34 milion €**, me focus për investime dhe përmirësime në shëndetësi.

Detyrimet e pa paguara 2024

NJËSIA	MALLRA DHE SHËRBIME 2024 (€)	SHPENZIME KOMUNALE 2024 (€)	SHPENZIME KAPITALE 2024 (€)	TOTAL OBLIGIMET 2024 (€)
S.P GJILAN	0,00	0,00	0,00	0,00
S.P PRIZREN	4,12	30.461,05	0,00	30.465,17
S.P GJAKOVË	0,00	0,00	0,00	0,00
S.P PEJË	2.809,50	341,31	0,00	3.150,81
S.P MITROVICË	11.423,82	0,00	0,00	11.423,82
S.P VUSHTRRI	0,00	0,00	0,00	0,00
S.P FERIZAJ	38.429,38	0,00	0,00	38.429,38
QKUK	1.048.572,10	330.691,71	223.300,23	1.602.564,04
SHËNDETI MENDOR	13.584,00	0,00	0,00	13.584,00
QSKUK	7.788,25	1.241,10	0,00	9.029,35
MJEKËSIA SË PUNËS	0,00	0,00	0,00	0,00
TELEMJEKËSIA	96,63	0,00	0,00	96,63
ADMINISTRATA	0,00	0,00	0,00	0,00
GJITHSEJ	1.122.707,80	362.735,17	223.300,23	1.708.743,20

- ❖ Obligimet totale të papaguara arrijnë në 1.7 milion €, me pjesën më të madhe të tyre të përqendruar në QKUK (1.6 milion €).
- ❖ Mallrat dhe shërbimet përbëjnë 1.12 milion € të detyrimeve, që reflekton varësinë e lartë të institucioneve shëndetësore nga furnizimet e ndryshme.
- ❖ Shpenzimet komunale kapin vlerën e 362 mijë €, të ndara kryesisht mes QKUK-së dhe disa spitaleve rajonale.
- ❖ Investimet kapitale kanë një total prej 223 mijë €, që lidhet kryesisht me projekte të infrastrukturës shëndetësore në QKUK.

Detyrimet kontigjente

Tabela 4 SHSKUK Rekapitulimi obligimet per detyrimet KONTIGJENTE për periudhen 2024

njesia	2024	2023	2022	2021	2020
Spitali i Përgjithshëm Gjilan	695,329.84	219,687.24	398,498.62	708,474.22	273,798.63
Spitali i Përgjithshëm Prizren	633,440.97	469,663.69	359,272.94	1,817,781.98	1,150,000.00
Spitali i Përgjithshëm Gjakovë	406,164.81	115,473.00	6,275.91	283,836.27	20,287.50
Spitali i Përgjithshëm Pejë	759,500.00	509	74,378.10	156,131.66	351,000.00
Spitali i Përgjithshëm Mitrovicë	336,851.46	236,351.38	238,503.59	126,970.31	181,147.69
Spitali i Përgjithshëm Vushtrri	132,714.47	62,597.31	50,757.26	61,046.59	30,404.13
Spitali i Përgjithshëm Ferizaj	15,866.00	43,130.43	44,681.79	117,113.81	31,613.92
QKUK	1,476,936.90	2,411,693.13	2,565,159.11	2,706,771.28	2,695,761.09
QSKUK	294,144.75	107,584.26		115,887.90	145,971.50
SHPSHM	125,554.36	33,005.97	40,705.46	126,870.63	
Mjekësia e Punes	45,424.27	17,363.09		10,446.60	6,695.76
ADMIN SITRATA E SHSKUK	1,469,786.78	1,389,127.01	105,043.38	500,147.06	785,045.37
GJITHSEJ	5,985,549.80	5,104,799.00	3,883,276.16	6,731,478.28	5,650,431.16

Ky raport paraqet analizën e obligimeve kontigjente të SHSKUK për vitin 2024, duke krahasuar ecurinë e tyre në periudhën 2020-2023. Detyrimet kontigjente përfaqësojnë shpenzime të mundshme të institucionit, të cilat nuk janë paguar ende, por pritet të realizohen në të ardhmen.

- ❖ Obligimet kontigjente për vitin 2024 kapin vlerën 5.98 milion €, një rritje e konsiderueshme krahasuar me 5.10 milion € në vitin 2023.
- ❖ QKUK mbetet institucioni me borxhin më të madh kontigjent, me një total prej 1.47 milion €, ndonëse ka shënuar një rënie nga 2.41 milion € në 2023.
- ❖ Rritje të ndjeshme kanë Spitali i Përgjithshëm i Gjilanit (695 mijë €) dhe Spitali i Përgjithshëm i Pejës (759 mijë €), duke reflektuar angazhimin financiar në këto qendra.
- ❖ Spitali i Përgjithshëm i Mitrovicës dhe Prizrenit gjithashtu kanë një barrë të konsiderueshme financiare, me detyrime prej 336 mijë € dhe 633 mijë € respektivisht.
- ❖ Në vitin 2021, detyrimet kontigjente ishin më të larta (6.73 milion €), por më pas u ulën në 2023 për t'u rritur sërish në 2024.

Shpenzueshmëria për barna dhe material shpenzues në SHSKUK

FURNIZIMET ME BRANA DHE MATERIAL SHPENZUES 2024

NJESIA	Sallo fill. 31.12.2023	Furnizimi nga LE Janar- Dhjetor 2024	Furnizimi nga Donacionet 2024	Regjistrimi i stokut të dates 31.12.2024 ne vlerë financiare	Gjithsej Furnzieimet dhe stoqet e bartura	Shpenzueshmëria pa mbetjet e stokut 31.12.2024
QKUK	5,547,828.59	41,656,437.83	1229433.82	10,343,876.48	48,433,700.24	38,089,823.76
SP GJILAN	144,877.31	878,548.13	2,263.76	138,242.68	1,025,689.20	887,446.52
SP PRIZREN	280,694.83	2,458,719.88	338.76	359,430.19	2,739,753.47	2,380,323.28
SP GJAKOVE	240,602.44	1,160,403.66		304,215.04	1,401,006.10	1,096,791.06
SP PEJE	234,759.12	1,444,071.00	88	415,473.23	1,678,918.12	1,263,444.89
SP MITROVICE	218,801.77	840,197.83		190,684.29	1,058,999.60	868,315.31
SP VUSHTRI	173,585.78	146,585.65		132,888.51	320,171.43	187,282.92
SP FERIZAJ	95,026.32	1,042,833.15	107.44	72,443.15	1,137,966.91	1,065,523.76
					0.00	0.00
TOTALI	6,936,176.17	49,627,797.13	12,296,231.78	11,957,253.57	68,860,205.08	56,902,951.51

- ❖ Vlera totale e furnizimeve për vitin 2024 ishte 49.62 milion €, nga të cilat pjesa më e madhe është siguruar nga fondet publike.
- ❖ Donacionet përbëjnë 12.29 milion €, një burim i rëndësishëm për sigurimin e materialeve të nevojshme shëndetësore.
- ❖ QKUK mbetet institucioni me furnizimin më të madh (41.65 milion €), duke përfshirë edhe donacione prej 12.29 milion €.
- ❖ Regjistrimi i stokut të fundit të vitit 2024 arrin në 11.95 milion €, duke treguar një menaxhim të kujdesshëm të furnizimeve.

Krahasimi i shpenzueshmërisë financiare për barna dhe material shpenzues në SHSKUK

	<i>Tabela 6. SHSKUK. Shpenzimi i barnave dhe materialit hargjues sipas viteve dhe Programeve 2024-2020</i>				
	2024	2023	2022	2021	2020
QKUK	38,089,823.76	41,212,679.37	39,332,512.33	41,485,645.57	26,909,950.38
SP GJILAN	887,446.52	991,265.41	959,058.08	1,202,896.00	1,024,395.00
SP PRIZREN	2,380,323.28	1,889,712.86	1,658,036.14	2,056,717.43	2,179,857.13
SP GJAKOVE	1,096,791.06	873,504.03	928,013.88	1,262,852.08	846,817.97
SP PEJE	1,263,444.89	1,407,073.26	1,308,908.19	1,967,844	1,311,703.00
SP MITROVICE	868,315.31	929,488.71	841,011.09	867,509.73	666,494.00
SP VUSHTRI	187,282.92	215,907.90	211,307.00	667,198.82	269,229.51
SP FERIZAJ	1,065,523.76	802,928.66	734,400.04	993,465.51	790,168.20
Shendeti mental	-	170,560.01	158,189.81	145,521.43	163,042.78
TOTALI	56,902,951.51	48,493,120.01	45,973,247.00	50,504,129.04	33,998,615.52

- ❖ Shpenzimet totale për vitin 2024 arritën në 56.90 milion €, një rritje prej 8.4 milion € krahasuar me 2023.
- ❖ QKUK mbetet institucioni me shpenzimet më të larta (38.08 milion €), ndonëse ka një ulje krahasuar me 2023 (41.21 milion €).
- ❖ Spitali i Prizrenit ka pasur një rritje të ndjeshme të shpenzimeve (2.38 milion € në 2024 nga 1.88 milion € në 2023).

- ❖ Spitalet e Pejës, Mitrovicës dhe Gjakovës kanë ruajtur nivele të qëndrueshme të shpenzimeve, me ndryshime të vogla.
- ❖ Shpenzimet për barnat dhe materialet e harxhueshme për shëndetin mendor kanë qenë zero për vitin 2024.

Krahasimi i të hyrave Financiare:

Vitet	Parking	Certifikata mjeksore	Shitja e sherbimeve	Shitja e mbeturinave	Qiraja	Participim	Kompenzim i dëmeve nga kompanit e sigurimit	Donacionet	Gjithsej
2024	342,325.50	486,352.00	75,547.42	5,719.50	142,383.03	2,449,131.13	-	-	3,501,458.58
2023	395,943.00	327,311.20	153,643.86	12,660.54	180,015.60	2,690,340.70			3,759,914.90
2022	407,142.00	261,497.50	51,492.54	9,203.80	121,820.20	2,378,060.34	1,235.00	4,577.24	3,235,028.62
2021	357,706.50	292,510.30	39,412.93	4,462.80	104,221.67	1,847,535.86	-		2,645,850.06

- ❖ Të ardhurat totale për vitin 2024 janë 3.50 milion €, me një rënie prej 258 mijë € krahasuar me vitin 2023 (3.75 milion €).
- ❖ Participimi i pacientëve vazhdon të jetë burimi kryesor i të ardhurave (2.44 milion €), që përbën mbi 70% të totalit.
- ❖ Të ardhurat nga certifikatat mjekësore arritën në 486 mijë €, duke shënuar një rritje të konsiderueshme nga 2023 (327 mijë €).
- ❖ Të ardhurat nga shitja e shërbimeve shënuan një ulje të ndjeshme, duke rënë nga 153 mijë € në 2023 në 75 mijë € në 2024.
- ❖ Shitja e mbeturinave gjithashtu ka rënë ndjeshëm nga 12 mijë € në 2023 në vetëm 5 mijë € në 2024.
- ❖ Të ardhurat nga qiraja ishin 142 mijë €, duke shënuar një rënie në krahasim me vitin 2023 (180 mijë €).

Donacionet

Njesia përberese SHSKUK	2024	2023	2022
Pershkrimi			
Pajsje Mjeksore	4,773,204.45	553,918.40	948,486.26
Produkte mjeksore	12,292,514.01	3,928,620.81	5,299,820.99
Te tjera	574,869.52	983,356.20	139,897.26
Donacione Covid-19			13,054.50
Gjithsej	17,640,587.98	5,465,895.41	6,401,259.01

- ❖ Totali i donacioneve të përfituara nga institucioni në vitin 2024 arriti në 17.64 milion €, një rritje e ndjeshme krahasuar me 2023 (5.46 milion €).
- ❖ Donacionet për pajisje mjekësore ishin 4.77 milion €, shumë herë më të larta se në 2023 (553 mijë €).
- ❖ Produkte mjekësore përbëjnë pjesën më të madhe të donacioneve (12.29 milion €), një rritje masive nga 3.92 milion € në 2023.
- ❖ Në kategorinë "Të tjera", vlera e donacioneve ishte 574 mijë €, më pak se në 2023 (983 mijë €).